



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.164 dt.06.11.1998

**PER  
MIRATIM FONDI PER BLERJE APARATI PER FOTOKOPJE A - O, NE  
FAVOR TE DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE URBANISTIKES.**

Këshilli i Bashkisë Tiranës, i mbledhjen sot me dt.06.11.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës “Për miratimin e fondit për blerjen e aparatit fotokopjues A – O”, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre,

**VENDOSI**

1. Të miratojë fondin prej 1.307.070 – 1.452.300 lekë për blerje të aparatit të fotokopjimit A – O të Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**